

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMES – MASTER

**DALLIMET NË PASIME TË SHKURTRA DHE TË GJATA TEK
FUTBOLLISTËT MESFUSHORË**

Mentori :
Prof. Asoc. Dr. Bylbyl Sokoli

Kandidati:
Qendrim Jahaj

Prishtinë , 2019

PËRMBAJTJA

1.HYRJE	3
2.HULUMTIMET E DERITANISHME	8
3.QËLLIMI I HULUMTIMIT	10
4.HIPOTEZAT THEMELORE	11
5.METODOLOGJIA E PUNËS	12
5.1.Mostra e popullatës.....	12
5.2.Mostra e ndryshoreve motorike specifike.....	14
5.2.1.Pasimet në total.....	15
5.2.2.Pasimet e sakta.....	17
5.2.3.Pasimet e pasakta.....	19
5.2.4.Pasimet e shkurtra të sakta.....	21
5.2.5.Pasimet e shkurtra të pasakta.....	23
5.2.6.Pasimet e gjata të sakta.....	25
5.2.7.Pasimet e gjata të pasakta.....	27
6. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE	29
7. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI	30
7.1. Përqindjet e pasimeve	30
7.2. Analiza deskriptive e rezultateve të mesfushorëve të Ligës së Parë	33
7.3. Analiza deskriptive e rezultateve të mesfushorëve të Superligës	36
7.4. Korelacioni ndërmjet pasimeve.....	39
7.5. Analiza e dallimeve ndërmjet dy grupeve	41
7.6. Vërtetimi i hipotezave.....	44
8. PËRFUNDIMI	45
9. LITERATURA	47
ABSTRAKTI	49
ABSTRACT	50

1.HYRJE

Futbolli loja e cila ka pushtuar planetin tokë. Është loja e cila ka bërë për vete miliarda njerëz. Loja e cila luhet me këmbë dhe ndërmjet dy ekipeve kundërshtare ka rrënjët e veta në Angli , aty ku është luajtur edhe ndeshja e parë dhe dalëngadalë është përhapur në të gjithë botën. Është sporti që ndiqet më endje anë e kënd botës, sporti që bashkon të gjithë dhe sporti që ofron evenimentin më të ndjekur ndonjëherë Kupën e Botës. Sa do që finalja e futbollit amerikan Super Bowl ka shikueshmëri të madhe apo edhe Olimpiada që ka interes të madh prapë se prapë finalja e Kupës se Botës është ajo që i lë në hije të gjitha evinimentet e mëdha. Edhe për vetë futbollistët asgjë nuk mund të krahasohet me Kupën e Botës duke e bërë këtë garë si të paprekshme dhe të ëndërruar për çdo futbollist.

Është vlerësuar se më shumë se gjysma e njerëzve në botë e konsiderojnë veten tifozë të futbollit. Sporti sot ka një ndikim të madh dhe gëzon rreth 4 miliardë njerëz që e ndjekin.¹

Sikur pothuajse në të gjitha vendet e botës edhe në Kosovë , futbolli ndiqet më shumë interes. Kosova si një vend i vogël ka kaluar nëpër periudha shumë të vështira si politike ashtu edhe sportive. Historia e futbollit kosovar është aq e bujshme sa që prej tij mund të nxirret një film rrënjëthës. Ky sport ishte krenaria e shqiptarëve të Kosovës në ish – Jugosllavi dhe ndahet në 5 periudha të ekzistimit te tij :

Periudha e Parë :

Topi i parë në Kosovë është sjellur nga një student i Grenoblit më 1919, por thuhet se më 1914 futboll kanë luajtur Austro-Hungarezët që kanë shërbyer në Kosovë në atë kohë. Futbolli në Kosovë është luajtur shumë herët, por klubet e para janë formuar në vitin 1922 në Gjakovë dhe KF “Prishtina” në Prishtinë, e më pastaj formohen edhe klubet e tjera. Garat nuk kanë qenë të rregullta për arsye të situatës jostabile që ka mbretëruar në atë kohë.

¹ <https://www.worldatlas.com/articles/what-are-the-most-popular-sports-in-the-world.html>

Periudha e Dytë :

Kjo periudhë fillon pas luftës së dytë Botërore prej vitit 1945 e deri më 1991. Në këtë kohë futbollit në Jugosllavi përparon në mënyrë të shpejtë e bashkë me të edhe futbollit kosovar, kur formohet edhe Federata e Futbollit të Kosovës më 1948, si degë e Federatës së Futbollit të Jugosllavisë. Në Ligën e parë jugosllave dallohen më së shumti KF “Prishtina”, kurse një vit anëtar i kësaj lige ishte edhe KF “Trepça” nga Mitrovica. Liga e dytë shtetërore vazhdimisht kishte nga 3-4 klube kosovare. Në këto dy liga Federative garonin Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Vojvodina, Kosova dhe Maqedonia, të gjitha në një ligë unike. Kosova e kishte ligën e vet të parë, ku skuadra kampione kalonte direkt në Ligën e dytë jugosllave, pastaj kishte Ligën e dytë dhe të tretë.

Kosova në këtë kohë kishte reprezentues, referë federativë dhe punëtorë të shumtë të nivelit më të lartë.

Periudha e tretë :

Në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë, pikërisht në vitin 1991 futbollit kosovar ishte në zenitin e saj dhe kishte vazhdimisht 4-5 klube në të dy ligat federative. Por, përkeqësimi i situatës politike reflektohej edhe në sport. Ishte gati e pamundur të luhej më futboll, e sidomos jo në Kosovë. Kjo bëri që në gusht të vitit 1991, klubi më i mirë i Kosovës, Prishtina me një traditë të ndritshme në Ligën e parë jugosllave të braktisë Ligën profesionale të Jugosllavisë, sepse nuk kishte më garancë për sigurinë as të lojtarëve, as të zyrtarëve të tjerë, por as të simpatizuesve kosovar.

Reaksioni i pushtetit të Millosheviqit ishte pa presedan në historinë e sportit. Ai suprimoi të gjitha klubet e të gjitha sporteve dhe definitivisht i largoi nga fushat e veta të gjithë sportistët e Kosovës, siç bëri edhe me punëtorët që i la në rrugë. Të gjitha nivelet e ligave të futbollit në Kosovë u zhdukën për një ditë nga dora kriminele e pushtetit serb.

Në vitin 1991, pas këtij akti të pashembullt të shtetit serbo-jugosllav, futbolldashësit kosovar treguan qartë se nuk mund të jetojnë pa futboll dhe në kushte absurde për shekullin e 20-të, formuan FEDERATËN E FUTBOLLIT TË KOSOVËS, të pavarur nga Jugosllavia me të gjitha organet e saja: kryetarin, bordin prej 12 anëtarëve nga 7 qendrat rajonale, komisionet, shoqatat. Ndeshja e parë u zhvillua në stadiumin e Flamurtarit në Prishtinë, më 13 shtator 1991, që shënoi

fillimin e kampionatit të parë të pavarur të Kosovës. Liga e parë e Kosovës numëronte 20 skuadra, ndërsa ligat tjera varësisht nga Regjionet, por ndeshjet luheshin vetëm nëpër fusha të improvizuara, në kushte shumë të vështira.

Nëpër stadiumet e futbollit të Kosovës luanin tani 8% e popullatës së gjithmbarshme të saj, pra vetëm serbët. Maltretimet, burgosjet, rrahjet ishin të pranishme në çdo javë, por futbollit në Kosovë mbijetoi dhe u luajt deri në janar të vitit 1998, kur filloi fushata luftarake serbe ndaj popullatës civile të Kosovës. Edhe gjatë kësaj periudhe (1991-1998) në Kosovë luhej futbollit sipas rregullave të UEFA-s dhe FIFA-s, dhe çdo ndryshim i rregullave të tyre menjëherë aplikoheshin në sistemin e garave tona.

Periudha e katërt:

Faza e IV-të e Futbollit në Kosovë filloi menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë më 1999, kur u riorganizua FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS. Konstituohet Kuvendi, miratohet Statuti, konfirmohen klubet pjesëmarrëse, caktohen komisionet, shoqatat, etj. Liga e parë numëronte 18 skuadra, Liga e dytë – dy grupe me nga 14 skuadra. Prej vitit 1991 vazhdimisht në futbollin e Kosovës është luajtur sipas rregullave të UEFA-së dhe FIFA-s, derisa interesimi për futboll ishte i madh, përkundër faktit se edhe më tutje FFK-ja vazhdonte të ishte jashtë organizmave ndërkombëtare. Me gjithë insistimin e vazhdueshëm për t'u bërë pjesë e UEFA-s e FIFA-s një gjë e tillë ishte pamundur të realizohej për shkak të rrethanave politike.

Kushtet infrastrukturale prej vitit 1999 e deri në anëtarësimin e Kosovës në UEFA e FIFA kanë qenë të vështira dhe futbollit ka mbijetuar vetëm falë sponsorëve vullnetarë, të cilët me vite të tëra kanë dhënë mjetet e tyre personale.

Periudha e Pestë:

Pas shumë peripecive, sakrificave të shumë gjeneratave, më në fund Federata e Futbollit e Kosovës, nën drejtimin e Fadil Vokrrit, pas shumë takimeve dhe lobimeve, arriti që t'i thyejë të gjitha barrierat dhe në maj të vitit 2016 të bëhet fillimisht anëtare e UEFA-s, e më pas edhe e FIFA-s, duke u bërë kështu pjesë e familjes së madhe të futbollit evropian dhe atij botëror.

Kjo periudhë vlerësohet edhe si më e rëndësishmja për zhvillimin e mëtejshëm të futbollit kosovar, pasi tani përveç se Kosova merr pjesë në kualifikimet e Evropianit dhe Botërorit me kombëtaren e saj, edhe klubet po paraqiten në garat evropiane².

Futboli i Kosovës po rritet vazhdimisht ashtu sikur edhe performancat e Përfaqësueses. Sa i përket cilësisë së futbollit në Kosovë po shihet se çdo kampionat po bëhet më interesant se ai paraprak. Këtë po e mundëson infrastruktura e cila po përmirësohet edhe pse hapa të ngadaltë e po ashtu edhe puna më e mirë dhe më profesionale që ka nisur të realizohet në disa klube. Kur flasim për infrastrukturën atëherë këtu kanë qenë ngecjet më të mëdha dhe kjo është arsyeja pse cilësia e futbollit kosovar është rritur shumë ngadalë. Këtu hyjnë stadiumet në gjendje të mjerueshme, terrenet aspak të përshtatshme e po ashtu edhe mungesa e fushave ndihmëse. Futboli dhe sporti kosovar në përgjithësi ka mbijetuar si shkak i pasionit të sportistëve dhe falë donatorëve që ndihmuan vullnetarisht.

Të gjithë lojtarët e një ekipi janë të rëndësishëm pa marr parasysh rolin që kanë në fushë. Secili në një mënyrë apo tjetrën jep kontributin që i takon por ndoshta mesfushorët janë ata që kanë barrën kryesore në ekip. Zakonisht në futbollin e të rinjëve mesfushorët janë vetëm lojtarë që luajnë në mesin e fushës. Me kalimin e kohës kur aftësitë e tyre si teknike ashtu edhe taktike përmirësohen ata ndahen në disa tipe të mesfushorëve: Mesfushorët anësor, defansiv (mbrojtës), mesfushorët qendror dhe ofansiv(sulmues).

1.Mesfushorët anësor janë ata lojtarë të cilët luajnë në krahët e fushës. Roli i tyre është që të mbrojnë në rastet kur ekipa kundërshtarë sulmon. Nëse nuk ka ndonjë kundërshtar në anën e tij ai futet në mes për t'i ndihmuar bashklojtarët. Në fazën sulmuese qëndron më shumë në krah dhe në këtë mënyrë e zgjeron mbrojtjen kundërshtarë duke liruar më shumë hapësira për sulmuesit e ekipës së tij. Ndërsa në fazën sulmuese ai duhet të jetë shumë i aftë për duelet 1 kundër 1.

² <http://ffk-kosova.com/historiku/>

2.Mesfushorët defansiv (mbrojtës) kanë për detyrë që të mbulojnë hapësirën ndërmjet mbrojtjes së ekipit të tij dhe sulmuesve kundërshtar. Këta mesfushorë mbajnë ekipin të bashkuar dhe kompakt në fazën e mbrojtjes , ushtrojnë presion të sulmuesit kundërshtar si dhe mbulojnë hapësirat e lëna nga bashklojtarët.

3.Mesfushorët qendror dominojnë në lojën rreth qendrës së fushës dhe për këtë arsye roli i tyre është i barabartë për nga kontributi si në fazën e sulmit ashtu edhe në fazën e mbrojtjes. Këta mesfushorë kalojnë topin të mesfushorët sulmues apo edhe direkt të lojtarët sulmues por edhe vet mund të afrohen afër zonës së kundërshtarit për ndonjë goditje potenciale drejtë portës. Sa i përket fazës së mbrojtjes detyrë e tyre është që të bllokojnë goditjet e kundërshtarëve dhe lojën e tyre.

4.Mesfushorët ofansiv (sulumues) janë mesfushorë të avansuar e zakonisht veprojnë ndërmjet mesfushorëve qendror dhe sulmuesve. Këta mesfushorë zakonisht janë lojtarë me vizion , me aftësi të mira me topin , driblues e po ashtu shumë krijues. Nganjëherë këta lojtarë njihen edhe si playmaker ose më herët numri 10 për shkak se shumë shpesh japin edhe pasimin final për gol të sulmuesit.

Mesfushorët janë ata që lidhin mbrojtjen me sulmin, janë motori i ekipit dhe janë ata që organizojnë pothuajse të gjitha aksionet. Mesfushorët kualitativ duhet të kenë mjaftueshëm cilësi sa që nuk duhet të mendojnë për kontrollin e topit por si ta shpërndajnë atë sa më parë. Gjithashtu mesfushorët duhet të jenë në gjendje të dinë të parashikojnë se çka do të ndodhë më pas.³

³ <https://www.footy4kids.co.uk/soccer-drills/tactics/the-job-of-a-midfielder/#>

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Në lidhje me performancën e mesfushorëve, në trevat tona, e veçanërisht në Kosovë, bazuar në njohuritë tona, nuk ka ndonjë informatë se është bërë ndonjë hulumtim i njëjtë apo i përafërt. Hulumtimet e vetme që janë bërë me futbollistët e Superligës , Ligës së Parë apo edhe në gjeneratat e reja në futboll janë bërë në aftësitë motorike sikur që janë shpejtësia , qëndrueshmëria , aftësitë funksionale e po ashtu edhe në parametrat antropometrik (masa trupore dhe ndikim e saj në realizimin e detyrave motorike).

Në futboll aftësia për të mbajtur posedimin një kohë të gjatë mundëson që ekipa më shumë gjasë të ketë rezultatin e favorshëm në fund të ndeshjes. (Hook and Hughes, 2001). Saktësia e këtij pohimi u vërtetua në sezonin 2001-2002 të Premier League-s ku u krahasuan 24 ndeshje . Ekipet e suksesshme u gjetë se kishin zotërim shumë më të madh të topit se ato humbëse. Por gjithashtu u gjetë se ekipet e suksesshme dhe ato të pasuksesshme kishin posedim më të madh të topit kur ishin duke humbur se sa kur ishin duke fituar. ⁴

Mesfushorët e dalluar nëpër botë dallohen më disa cilësi si fizike , tekniko-taktike e po ashtu edhe me kreativitetin e tyre në fushën e lojës. Një cilësi shumë domethënëse dhe e rëndësishme për futbollistët e sidomos mesfushorët janë pasimet. Numërimi i pasimeve është i lehtë, por e rëndësishme është se kush janë pasuesit më të mirë dhe cili është impakti i tyre në lojën e ekipit.

Zakonisht lojtarët më të mirë të futbollit janë pasuesit më të mirë dhe të gjithë lojtarët pa marr parasysh pozicionin ku luajnë duhet ta përmirësojnë këtë aftësi. Në shikim të parë pasimi duket i thjeshtë por në fakt është shumë i vështirë për t'u perfeksionuar. Pasimi bënë pjesë në elementet teknike me top dhe është ndër teknikat e para që mësohen në futboll. Dy llojet e njohura të pasimeve janë: pasimi i shkurtë dhe pasimi i gjatë, për të cilët edhe u realizua ky studim. Pasimi i mirë ndihmon në zotërimin më të madh të topit dhe kjo të ofron shans më të madhe për fitore përndryshe si pritet të shënohet gol nëse ekipi nuk ka topin ?

⁴ (Hook and Hughes, 2001).

Në këtë sezon (2018-19) të Premier League-s në Angli, Jorginho mesfushori i tanishëm i Chelsea-t në një ndeshje ka bërë 186 prekje të topit , 173 pasime dhe prej të cilave 158 pasime të sakta , 27 më shumë se i gjithë ekipi kundërshtar nga Newcastle.

E nëse shikojmë nga saktësia është mesfushori i Manchester City Ilkay Gundogan i cili ka realizuar 167 pasime të sakta në ndeshjen ndaj Chelsea-it po në sezonin 2018-19.⁵

Ndërsa në një studim tjetër që u bë po në Angli dhe po lojtarit të njëjtë (Ilkay Gundogan), ofron krahasime statistikore ndërmjet tij dhe bashklojtarëve por edhe lojtarëve kundërshtar. Ky studim jep të dhënat statistikore mesatare për pasimet por edhe elementet tjera në ndeshjet e luajtura në edicionin 2018-2019 në Premier League.

Kur mesfushorët e Man.City luajnë si mesfushorë qendror më të avansuar këto janë statistikat mesatare :

	Pasime për ndeshje	Përqindja e saktësisë
Ilkay Gundogan	59.15	89.5 %
De Bryne	60.73	79.8 %
David Silva	69.5	87.6 %
Foden	51.43	88.8 %
Bernardo Silva	50.89	87.8 % ⁶

Shprehia e pasimit është një ndër faktorët kryesor për performancën e suksesshme në sportet ekipore.(RobertRein,DominikRaabe,DanielMimmert,2017)

7

⁵ <https://www.premierleague.com/news/834597>

⁶ <https://totalfootballanalysis.com/player-analysis/tactical-analysis-ilkay-gundogan-manchester-city-premier-league-analysis>

⁷ Robert Rein , Dominik Raabe , Daniel Mimmert

3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Meqë në Kosovë asnjëherë nuk është bërë një hulumtim për futbollistët nga ana teknike (pasimet) atëherë vlerësoma se është shumë domethënëse të realizohet një i tillë. Ky hulumtim do të shërbej për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të dinë performancat në pasime të një mesfushori gjatë një ndeshje kampionale. Një studim i tillë ndoshta në të ardhmen do t'i hap rrugë edhe shumë studimeve tjera më të detajuara jo vetëm në elementin e pasimit por edhe në veçoritë tjera si teknike apo edhe taktike të futbollistëve pa marrë parasysh rolin në fushë.

Si qëllim kryesor i këtij hulumtimi është krahasimi i mesfushorëve të Superligës dhe Ligës së Parë në elementin teknik të pasimit i cili është shumë domethënës për cilësinë e një futbollisti e sidomos një mesfushori.

Ndërsa si qëllime tjera janë edhe :

Vlerësimi i numrit të pasimeve për një ndeshje në total për të dyja rangjet.

Vlerësimi i numrit pasimeve të sakta edhe të pasakta në bazë të klasifikimit si më sipër.

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të qëllimit këtij hulumtimi janë parashtruar këto hipoteza:

H-1. Pritet se rezultatet e fituara të parametrave themelor statistikor të ndryshoreve motorike specifike tek mesfushorët e Superligës dhe Ligës së Parë nuk do të kenë asimetri të theksuar.

H-2. Pritet korrelacione të rëndësishme statistikore në ndryshoret motorike specifike tek mesfushorët e Superligës dhe atyre të Ligës së Parë .

H-3. Priten dallime statistikisht të vlefshme të ndryshoreve motorike specifike ndërmjet mesfushorëve të Superligës dhe atyre të Ligës së Parë.

5. METODAT E HULUMTIMIT

5.1. Mostra e popullatës

Në këtë hulumtim janë përfshirë lojtarët mesfushorë të ekipeve të Ligës së Parë dhe Superligës së Kosovës në Futboll, sezoni pranveror i kalendarit të garave 2018-2019.

Ndeshjet e po ashtu edhe mesfushorët u zgjodhën në mënyrë krejtësisht rastësore. Për dallim nga Superliga ku 5 ndeshjet e inçizuara u siguruan menjëherë nga Platforma Digitalb e cila ka edhe të drejtën e transmetimit të Superligës, nga Liga e Parë u analizuan 6 ndeshje. Kjo për shkakun se nuk ishte e mundur të siguroheshin inçizime nga shumica e ekipeve , kështu që tri ndeshje u siguruan nga klubi KF Istogu ku në dy takime janë vlerësuar vetëm mesfushorët e ekipeve kundërshtarë të ekipit në fjalë. Në secilën prej këtyre ndeshjeve janë marrë për analizë nga 6 mesfushorë , për secilën ekip nga 3 mesfushorë.

Grumbullimi i informacioneve për ndryshoret e aplikuara në këtë punim është realizuar nga këto ndeshje të Superligës dhe Ligës së Parë:

- 1.Prishtina 3-0 Flamurtari Java 23 Superligë
- 2.Drita 0-0 Gjilani Java 26 Superligë
- 3.Feronikeli 1-2 Ferizaji Java 27 Superligë
- 4.Llapi 4-1 Trepça 89 Java 30 Superligë
- 5.Drenica 1-1 Ballkani Java 32 Superligë

1. Onix 0-2 Arbëria Java 22 Liga e Parë
- 2.2 Korriku 4-0 Vushtrria Java 26 Liga e Parë
3. Istogu 2-1 Vëllaznimi Java 29 Liga e Parë
4. Drenasi 1-1 Kika Java 20 Liga e Parë
5. Istogu 2-1 Fushë Kosova (Vetëm tre mesfushorët e Fushë Kosovës) Java 21 Liga e Parë
6. Istogu 1-0 Ramiz Sadiku (Vetëm tre mesfushorët e Ramiz Sadikut) Java 27 Liga e Parë

Të gjitha të dhënat e mesfushorëve në këto ndeshje janë nxjerrë nga video inçizimet. Nga ndeshjet e sipërpërmendura u analizuan gjithsej 60 mesfushorë, 30 mesfushorë të Superligës dhe 30 mesfushorë të Ligës së Parë. Po ashtu edhe terrenet në të cilat janë zhvilluar këto ndeshje janë zgjedhur me kujdes që të mos ketë dallime në cilësinë e fushës . Kushtet kanë qenë optimale për lojë çka është bërë e mundur që vlerësimi të jetë sa më real.

Vlen të theksohet se video inçizimet janë ndaluar vetëm në ato momente kur mesfushorët ishin në veprim me topin.

5.2. Mostra e ndryshoreve motorike specifike

Në bazë të qëllimit që synohen të arrihet në këtë punim për secilin mesfushor janë analizuar këto lloje të pasimeve:

- 1.Pasimet në total ----- PT
- 2.Pasimet e sakta ----- PS
- 3.Pasimet e pasakta ----- PPS
- 4.Pasimet e shkurtra të sakta ----- PSHS
- 5.Pasimet e shkurtra të pasakta -- PSHPS
- 6.Pasimet e gjata të sakta ----- PGJS
- 7.Pasimet e gjata të pasakta ----- PGJPS

Në figurat që do të shohim më poshtë janë paraqitur edhe se si janë vlerësuar pasimet e sakta apo edhe ato të pasakta. Rruga që përshkon topi gjatë pasimit të saktë është e shënuar me shigjetë të zezë ndërsa rruga që përshkon topi gjatë pasimit të pasaktë është shënuar me shigjetë të kuqe.



Pasim i saktë



Pasim i pasaktë

5.2.1. Pasimet në total (PT)

Të gjitha pasimet qofshin ato të shkurtra apo të gjata , të sakta apo të pasakta do të vlerësohen dhe do të hyjnë në pasimet në total. Në këtë kategori të pasimeve pra hyjnë pasimet me këmbë, me kokë ose me gjoks të cilat një mesfushor i realizon duke pasuar për bashklojtarin e tij apo edhe duke pasuar gabimisht jashtë fushe ose te kundërshtari.




Foto 1. Pasim i saktë.



Foto 2. Pasim i pasaktë.



Foto 3. Pasim i pasaktë më kokë.

5.2.2. Pasimet e sakta (PS)

Të gjitha pasimet të shkurtra apo të gjata më të cilat mesfushori e gjenë bashklojtarin e tij hyjnë te pasimet e sakta. Të këto pasime qëllimi i mesfushorëve është që të gjejnë saktë bashklojtarin e tyre qoftë ai mbrojtës, sulmues apo edhe mesfushor. Si pasime të sakta janë vlerësuar pasimet me këmbë, kokë, gjoks apo edhe me ndonjë pjesë tjetër të trupit.



Foto 4. Pasim i saktë.



Foto 5. Pasim i saktë.



Foto 6. Pasim i saktë.

5.2.3. Pasimet e pasakta (PPS)

Në lojën e futbollit jo të rralla janë edhe pasimet e pasakta .Normalisht që për një mesfushor është e rëndësishme që ai të jetë në shumicën e kohës i saktë por ndodh që ka edhe gabime në pasime. Të gjitha pasimet ku mesfushori gjatë realizimit humbet topin ose nuk e gjenë bashklojtarin hyjnë te pasimet e pasakta.



Foto 7. Pasim i pasaktë.



Foto 8. Pasim i pasaktë.



Foto 9. Pasim i pasaktë.

5.2.4. Pasimet e shkurtra të sakta (PSHS)

Në pasimet e shkurtra hyjnë të gjitha ato pasime në distancën deri në 30m ku mesfushori pason saktë te bashklojtari i tij. Janë pasime më lehtë të realizueshme prandaj edhe mesfushorët gjatë ndeshjes kanë më shumë pasime të shkurtra. Në këto lloje të pasimeve janë vlerësuar edhe pasimi me kokë dhe me gjoks.



Foto 10. Pasimi i shkurtër i saktë.



Foto 11. Pasimi i shkurtër i saktë me kokë.



Foto 12. Pasim i shkurtër i saktë.

5.2.5. Pasimet e shkurtra të pasakta (PSHPS)

Në pasimet e shkurtra të pasakta hyjnë të gjitha ato pasime në distancën deri në 30m ku mesfushori pason gabimisht ose nuk gjenë bashklojtarin e tij duke dërguar topin jashtë fushe.



Foto 13. Pasim i shkurtër i pasaktë.



Foto 14. Pasim i shkurtër i pasaktë.



Foto 15. Pasim i shkurtër i pasaktë.

5.2.6. Pasimet e gjata të sakta (PGJS)

Pasimet që janë më të vështira për t'u realizuar në lojën e futbollit janë pasimet e gjata për faktin që distanca është më e gjatë dhe kërkohet saktësi e madhe. Në pasimet gjata të sakta hyjnë të gjitha ato pasime në distancën prej 30m e më shumë ku mesfushori pason saktë te bashklojtari i tij.



Foto 16. Pasim i gjatë i saktë.



Foto 17. Pasim i gjatë i saktë.



Foto 18. Pasim i gjatë i saktë.

5.2.7. Pasimet e gjata të pasakta (PGJPS)

Duke ditur që janë pasime të gjata atëherë e dimë që mund të këtë edhe gabime gjatë realizimit të tyre . Në pasimet e gjata të pasakta hyjnë të gjitha ato pasime në distancën prej 30m e më shumë ku mesfushori pason gabimisht topin duke e dërguar jashtë fushe ose nuk pason saktë te bashklojtari e tij.




Foto 19. Pasim i gjatë i pasaktë.



Foto 20. Pasim i gjatë i pasaktë.



Foto 21. Pasim i gjatë i pasaktë.

6. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Rezultatet janë pothuajse pjesa kryesore e një studimi. E këto rezultate patjetër që kërkojnë shumë punë në përpunimin e tyre.

Në këtë studim janë analizuar për të gjithë mostrën këto parametra themelor statistikor :

Mesatarja aritmetikore --- MA

Devijimi standard ----- DS

Vlera minimale ----- Min

Vlera maximale ----- Max

Lakorja e shpërndarjes me anë të koeficientit të asimetrisë ----- SKEW (Skjunis) dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës ----- KURT (Kurtozis)

Saktësia e pasimeve është paraqitur me anë të përqindjeve për të dyja nivelet , ndërsa për vlerësimin e ndërlidhjeve ndërmjet variablave është përdorur testi Pearson i korrelacionit.


Për të analizuar dallimin në pasime në mes të mesfushorëve të Superligës dhe Ligës së Parë është përdorur T- Testi për testimin e variablave numerike si dhe analiza deskreptive.

Rezultatet janë përpunuar me Paketën Statistike për Shkencat Sociale (SPSS) , version (20.0.).


7. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

7.1 Përqindjet e pasimeve

Ashtu siç është cekur më lartë saktësia e pasimeve është paraqitur me anë të përqindjeve për të dy rangjet e garave. Sa i përket numrit total të pasimeve, mund të vërehet se lojtarët e Superligës shfaqen një saktësi më të madhe kundrejt lojtarëve të Ligës së Parë. Siç është paraqitur në Graf.1 dhe Graf 2, përqindja totale e pasimeve të sakta tek futbollistët e Superligës është 14% më e lartë sesa e atyre të Ligës së Parë.




Graf 1. Përqindja e pasimeve të sakta dhe të pasakta te mesfushorët e Superligës.




Graf 2. Përqindja e pasimeve të sakta dhe të pasakta te mesfushorët e Ligës së Parë.

E nëse i shikojmë pasimet e shkurtra të sakta atëherë edhe këtu e vërejmë një diferencë por më të vogël ndërmjet këtyre dy kategorive ku mesfushorët e Superligës janë për 11% më të saktë se ata të Ligës së Parë. Këtë e tregojnë Graf.3 dhe Graf.4




Graf 3. Përqindja e pasimeve të shkurtra të sakta dhe të shkurtra të pasakta te mesfushorët e Superligës.




Graf 4. Përqindja e pasimeve të shkurtra të sakta dhe të shkurtra të pasakta te mesfushorët e Ligës së Parë.

Dallimi më i vogël në përqindje ndërmjet këtyre dy grupeve është të saktësia e pasimeve të gjata. Këtu vërehet një saktësi më e madhe e mesfushorëve të Superligës të cilët janë treguar më të saktë për vetëm 1%. Por ndryshe nga dy ndryshoret më lartë këtu kemi rënje të dukshme të saktësisë tek të dyja rangjet e ligave (Graf 5 dhe Graf 6).



Graf 5. Përqindjet e pasimeve të gjata të sakta dhe të gjata të pasakta te mesfushorët e Superligës.



Graf 6. Përqindjet e pasimeve të gjata të sakta dhe të gjata të pasakta te mesfushorët e Ligës së Parë.

7.2 Analiza deskriptive e rezultateve të mesfushorëve të Ligës së Parë

Në tekstin në vazhdim, do të paraqiten dhe analizohen parametrat themelor statistikor, të asimetrisë dhe shpërndarjes normale për çdo variable motorike specifike të aplikuara në këtë punim sipas radhitjes. Në tabelën 1 janë të pasqyruara karakteristikat themelore statistikore të sistemit të aplikuar të variablave specifike-motorike (nga Liga e Parë ku u analizuan 6 ndeshje) dhe janë përfshirë 30 mesfushorë. Janë paraqitur: Vlerat minimale (Min), vlerat maksimale (Max), mesatarja aritmetikore (Mean), Devijimi standard (Std. Dev), Parametrat e asimetrisë (SKEW dhe KURT).

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të asimetrisë dhe shpërndarjes normale të variablave motorike specifike të Ligës së Parë në futboll

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
PT	30	7	66	27.1667	15.58754	1.225	0.868
PS	30	6	54	19.7667	12.90732	1.339	0.983
PPS	30	1	19	7.4	3.86496	0.803	1.409
PSHS	30	5	51	17.6667	11.85351	1.338	1.03
PSHPS	30	0	12	4.4	2.634	0.697	1.179
PGJS	30	0	10	2.2	2.35475	1.492	2.791
PGJPS	30	0	7	2.9	2.09021	0.773	-0.235

Mesatarja aritmetikore Pasimet në total (PT), (27.16) Rezultati minimal (7.00) dhe ai maksimal (66.00). Rezultatet e Pasimeve në total tregojnë se në mes futbollistëve ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal dhe se ekziston një dallim i theksuar në mes futbollistëve në këtë ndryshore të Pasimeve totale, dhe ekziston një anim i lehtë i rezultateve kah më të ulëta sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtik). Dallim i theksuar

në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar, kurba është mezokurtike.

Mesatarja aritmetikore Pasimet e sakta (PS), (19.76) Rezultati minimal (6.00) dhe ai maksimal (54.00). Rezultatet e pasimeve të sakta tregojnë në mes mesfushorëve ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal dhe se ekziston një dallim i theksuar në mes mesfushorëve në këtë ndryshore të pasimeve të sakta, dhe ekziston një anim i lehtë i rezultateve kah më të ulëta sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtik). Dallimi i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, tregon se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) tregojnë një asimetri të theksuar, kurba është mezokurtike.

Mesatarja aritmetikore Pasimet e pasakta (PPS), (7.4) Rezultati minimal (1.00) dhe ai maksimal (19.00). Rezultatet e Pasimeve të pasakta tregojnë në mes mesfushorëve ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal dhe se nuk ekziston një dallim i theksuar në mes mesfushorëve në këtë ndryshore të Pasimeve të pasakta, dhe ekziston një anim i lehtë i rezultateve kah më të ulëta sepse testi i asimetrisë është pozitive (epikurtik). Edhe pse ekziston një dallim i theksuar në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar, kurba është mezokurtike.

